

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Vuno shpallet “Qendër Historike”, Qeveria miraton zonën e mbrojtur dhe planin e administrimit                                                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://newsbomb.al/aktualitet/vuno-shpallet-qender-historike-qeveria-miraton-zonen-e-mbrojtur-dhe-p-i402039">https://newsbomb.al/aktualitet/vuno-shpallet-qender-historike-qeveria-miraton-zonen-e-mbrojtur-dhe-p-i402039</a> |
| BURIMI  | newsbomb.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 15:25:14 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:21:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 5df7ea43dae6165be06114b9e87341bdd26076e957871657d10c0c49ffec1d44 |
| TEKSTI     | 648465b8300f89cb689285db2066f4377f519769996d36737f785f1ee0e39c7f |
| PAMJA      | 4d154e3af2574533fcb29f6df49d1c97cbf02b57458774f93af9d51b1d0082a6 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | d32cff277b8e754849122dcea3ff57372b441d117d0cf048caf304c1a8f4fbd4                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d32cff277b8e754849122dcea3ff57372b441d117d0cf048caf304c1a8f4fbd4>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



12 numrat e parë FALAS!  
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë &amp; Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



## Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

25 Shtator 2026, 17:21

# Vuno shpallet "Qendër Historike", Qeveria miraton zonën e mbrojtur dhe planin e administrimit



Shkruar nga Newsbomb



Fshati Vuno

Fshati Vuno në Himarë merr zyrtarisht statusin e "Qendrës Historike", pas vendimit të marrë në mbledhjen e sotme të Këshillit të Ministrave.

Përmes këtij vendimi, Vunoja deklarohet pasuri kulturore e paluajtshme, ndërsa përcaktohet edhe zona mbrojtëse që rrethon qendrën historike. Krahas kësaj, Qeveria ka miratuar planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj.

Sipas vendimit, kufijtë e qendrës historike dhe zonës mbrojtëse përcaktohen përmes hartave të zonifikimit dhe koordinatave të sistemit zyrtar gjeodezik shqiptar, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të miratuar.

Në të njëjtën kohë, vendimi i ri shfuqizon vendimin e vitit 2016 për shpalljen e Qendrës Historike të Vunos dhe rregulloren për administrimin e saj dhe të zonës së mbrojtur përreth.

Për zbatimin e masave të reja janë ngarkuar disa institucione, mes tyre Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Himarë.

**Vendimi i Këshillit të Ministrave:**

## Revista



Abonohu tani dhe lexoje &gt;

## Lajmet e fundit



## Politikë

100 apo 15 bashki? Demokratët e socialistët bëjnë lëvizjen e radhës, PD i dërgon draft ligjin Kuvendit, mazhoranca kërkon aprovimin e Peleshit



## Politikë

Edi Rama nga New York: Joe Biden e tradhtoi Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të

Zbulu më shumë artikuj &gt;

Vendim për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "qendër historike" të fshatit Vuno, përcaktimin e zonës mbrojtëse dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" e "ç", të pikës 3, të nenit 9, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

#### Vendos:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Qendër historike" të fshatit Vuno dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas hartave të zonifikimit dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" të fshatit Vuno dhe të zonës mbrojtëse të saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Vendimi nr.30, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Vuno dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj të zonës së mbrojtur përreth", shfuqizohet.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të "Qendrës historike" të fshatit Vuno dhe të zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.

6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 16:43

**U qëllua me vezë nga shqiptarët në New York, Rama dy fjalë për protestuesit: Pulat hysterike të katundit tonë kakarisin, s'do të më ndalni me baltë e jargë**



Aktualitet

**DALIN PAMJET!** Si u vra në mes të Sarandës Artan Myrtaj, atentatori e ndoqi me vrap për disa metra dhe e ekzekutoi nga afër

E Premte 15:39



Aktualitet

Gjenerali Eric Wendt shkel në tokën shqiptare, ambasadori i ri amerikan mbërrin në Tiranë (AXHENDA)

E Premte 15:27



E Premte 15:03

## Plagosje me armë zjarri të “Zogu i Zi”, një shtetas nga Kosova dërgohet me urgjencë të Trauma (DETAJET E PARA)



Aktualitet

“Nuk do t’i lëmë të na bëjnë të fortin”, si degradoi nga TikTok-u sherri mes të miturve në Yzberisht, mblohdën shokët dhe shkuan të “sqarohen”

E Premte 13:58



Aktualitet

Turistja çeke dhe i dashuri i saj humbin bagazhet në autobusin e Shkodrës, denoncojnë në internet “Kompaninë BERISHA”: Çantat tona ranë rrugës, kur na i kthyen ishin të hapura (FOTO)

E Premte 13:44





E Premte 13:35

## Parandalohet tragjedia në Yzberisht, 23 të mitur shkojnë të rrihen me njëri-tjetrin, me vete kishin shkopa bejsbolli, blutë e 6-tës ndërhyjnë menjëherë



Aktualitet

NUK KA MË SEKRETE! Sali Berisha nxjerr FOTON e drejtorit të Operacionales në SHISH dhe shkruan: Te lokali i tij në Bërzhitë takoheshin Gysi dhe Vlora

E Premte 13:27



Aktualitet

Vlora Hyseni nën akuzë në Shqipëri, mediat në Rumani japin ALARMIN: Është stërvitur nga Gjenerali i Zi, Coldea ishte këshilltar i kryeministrit Rama dhe shef i spiunazhit rumun

E Premte 13:04



E Premte 12:27

## Dy 22 vjeçarët me parcelë kanabisi në Skrapar, i ruanin bimët me kallashnikov, sapo panë Policinë hodhën armën dhe u futën në pyll



Aktualitet

VIDEO/ "Të q\*fsha motrën", shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë

E Premte 12:03



Aktualitet

"Pushtetet janë të ndara, por shteti është një", kryegjyqtari Sokol Sadushi kundër idesë së Edi Ramës për të shqyrtuar pagat: Kushtetuta nuk negociohet, Gjykata ka folur (FJALA E PLOTË)

E Premte 11:05



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.